

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA KOMBETARE NOTEREVE
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 121..... rep.

Nr. 09..... kol.



**KONTRATË DHURIMI
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
MEI 2018 SHPK**

Sot, ne Tiranë, me datë 09/01/2020, perpara meje Z. HelianZenelaj, Noter prane Dhomes Kombetare se Notereve, Dega Vendore Tiranë, me adrese ne Rr. Kont Urani 3, Tiranë u paraqiten personalisht palet e me poshtme:

Z. Ermal Mamaqi atësia Drini, lindur në Tiranë me 21/03/1982 dhe banues në Tiranë rr Vaso Pasha P16 Sh2 Ap 3, me nr personal letërnjoftimi, I20321141F madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar..

(Këtu e mëposhtë referuar si **“Dhuruesi”**)

Shoqëria Best Invest shpk e regjisturar ne QKB me NUIS: L62318005A me përfaqesues ligjor Z. Eglent Bici , atësia Kasëm lindur ne Gramsh me 28.08.1976 dhe banues ne Tiranë Rr. “Don Bosko” , banesë private Nr. 69 , me nr leternjoftimi H60828061U , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar(Këtu e mëposhtë referuar si **“Pranues i Dhurimit”**)

Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen bashkërisht si **“Palët”**.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë te Shitjes së kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE:

- Dhuruesi zotëron 40 % të kapitalit me një vlerë totale prej 40,000 Lekë të shoqërisë **“Mei2018”** sh.p.k, me Nr. Nipt:L81718028D, (këtu e mëposhtë referuar si **“Shoqëria”**).
- Pranuesi i dhurimit zotëron 60% te kapitalit me nje vlere totale prej 60,000 (gjashte dhjete mije) Leke të shoqërisë **“Mei2018”** sh.p.k, me Nr. Nipt:L81718028D.

Neni 1



Objekti i Kontratës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Dhurusi i dhuron Pranuesit të Dhurimit, 40 % të kuotave kapitalit të shoqërisë, me një vlerë të përgjithshme prej 40,000 (dyzet mijë) Leke. Ky dhuim bëhet pa asnjë lloj shpërblimi monetar.
- 1.2 Pranuesi i dhurimit bëhet pronar i 100 % të kuotave të kapitalit.
- 1.3 Pranuesi i dhurimit deklaron se e pranon dhurimin e pjesëve (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.4 Transferimi nëpërmjet dhurimit do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 2

Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Pranuesi i Dhurimit bëhen zotëues 100% të kuotave kapitalit të Shoqërisë, duke u bërë titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

Neni 3

Garancitë

- 4.1 Dhuruesi deklaron se garanton Pranuesin e Dhurimit se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfarëdoq dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohej për shkak të forcave madhore ose rastit faktor dhe në mënyrë të veçantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmblytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime,

shpronësime, ose akte të pushtetit qendror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 5

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 6

Legjislacioni i zbatueshem

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarreshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

Neni 8

Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Paleve.

Neni 9

Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Neni 10

Hyrja ne fuqi

- 11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 11



Gjuha e kontratës

12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.


Une Noteri, pasi ua lexova me zë të lartë dhe te qarte Palëve tekstin e kësaj kontrate dhe konstatova bazuar në deklaratimet e vetë palëve, se ata e kuptojnë të gjithë përmbajtjen e kontratës, dhe se e gjejnë kontratën të rregullt në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe e nënshkruajnë atë rregullisht, ndërsa Une Noteri i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

PALËT

Dhuruesi

Ernal Manaj


Pranuesi i Dhurimit



NOTERI
ILDIAN ZENELA
C.R.I. : 0674019720

